



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI



unicef 
for every child

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

NDËRMJET:

Kuvendit të Shqipërisë, me seli në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit” Tiranë, përfaqësuar nga Kryetari, **Sh.T.Z. Gramoz Ruçi**, shkurt “Kuvendi”,

dhe

Fondit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijët, organizatë ndërkombëtare e ndërshtetërore, themeluar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, me zyrat në rrugën “Skënderbej”, Ndërtesa e Volkswagenit, kati III, Tiranë, përfaqësuar nga **Z. Ezio Gianni Murzi**, Përfaqësues i komanduar, shkurt “UNICEF”.

Kuvendi dhe UNICEF-i do të emërtohen “**Palët**”.

Duke marrë parasysh se:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI



- A. Kuvendi ka një rol kyç në çuarjen përpara të një programi legjislativ në mbrojtje dhe nxitje të të drejtave të fëmijës;
- B. Kuvendi është institucioni më i rëndësishëm kushtetues, i cili nëpërmjet ushtrimit të funksionit të kontrollit parlamentar, realizon mbikqyrjen e zbatimit të ligjeve nga organet e pushtetit publik, lidhur me realizimin e të drejtave të fëmijës;
- C. Kuvendi është institucioni që miraton buxhetin që i duhet pushtetit ekzekutiv për zbatimin e politikave publike, përfshi edhe ato që kanë të bëjnë me përparimin e të drejtave të fëmijës, dhe njëkohësisht mbikqyr shpenzimet e Qeverisë;
- D. Kuvendi është institucioni kryesor që sjell në qendër të debatit publik çështjet që prekin të drejtat e njeriut të fëmijëve dhe që krijon shembullin e përfshirjes së fëmijëve në vendimmarrje;
- E. Kuvendi është forca më e madhe udhëheqëse e Reformës në Sistemin e Drejtësisë;
- F. UNICEF-i, në kuadër të Programit të Bashkëpunimit ndërmjet Kombeve të Bashkuara dhe Qeverisë së Shqipërisë (2012-2016), ka advokuar për krijimin e grupit parlamentar “Miqte e Fëmijëve” (GPMF) dhe do të vijojë t’i ofrojë atij mbështetje teknike, në bazë të Programit të Bashkëpunimit (2017-2021);
- G. UNICEF-i, në kornizën e mandatit të tij, ofron mbështetje për Kuvendin, për komisionet e tij të përhershme dhe të posaçme, nënkomisionet parlamentare, komisionet si dhe për grupimet e ndryshme të deputetëve, me qëllim forcimin e roleve të tyre ligjvënëse, të kontrollit dhe të ndërgjegjësimit publik për çuarjen përpara të punës për të drejtat e njeriut të fëmijëve si dhe punës për barazinë e mundësive dhe rezultateve;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI



unicef 
for every child

Palët, bien dakord për sa më poshtë:

NENI 1

Qëllimi i Memorandumit:

Memorandumi ka për qëllim të vendosë bashkëpunimin institucional mes Palëve, me synim forcimin e rolit ligjvënës, kontrollues dhe ndërgjegjësues të Kuvendit, komisioneve të tij të përhershme dhe të posaçme, nënkomisioneve parlamentare, përfshi grupin e deputetëve “Miqtë e Fëmijëve”, në çuarjen përpara të të drejtave të njeriut të fëmijëve. Përmes këtij Memorandumi, Palët përcaktojnë angazhimet dhe detyrimet e përbashkëta, të nevojshme për zbatimin e aktiviteteve.

NENI 2

Baza juridike

2.1 Ky Memorandum bazohet në:

- a) Marrëveshjen Bazë të Bashkëpunimit, nënshkruar nga Qeveria e Shqipërisë dhe UNICEF, më 23 korrik 1993;
- b) Programin e Bashkëpunimit, nënshkruar nga Qeveria e Shqipërisë dhe Kombet e Bashkuara, më 24 tetor 2016, për periudhen 2017-2021;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI



unicef 
for every child

c) Dokumentin e Programit të UNICEF-it për Shqipërinë, miratuar nga Bordi Ekzekutiv i UNICEF-it në shtator 2016, për periudhen 2017-2021.

2.2 Pas përfundimit të Programeve të përmendura në pikën 2.1, geramat b dhe c, Palët do ta vazhdojnë bashkëpunimin e tyre, bazuar në Programet e Bashkëpunimit vijuese, për vitin 2021 e mëtej, përveç rastit kur Palët vendosin ndryshe me marrëveshje.

NENI 3

Objekti dhe Fusha e veprimitarisë

3.1 Objekti i Memorandumit është mbështetja teknike e Kuvendit, komisioneve të tij të përhershme, dhe atyre të posaçme, nënkomisioneve, përfshi grupin e deputetëve “Miqtë e Fëmijëve”, në çuarjen përpara të punës për të drejtat e njeriut të fëmijëve, veçanërisht në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga Rezoluta e Kuvendit lidhur me Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, miratuar në nëntor 2013, si dhe letërkëmbimit në vitin 2015 mes UNICEF-it, nga njëra anë, dhe Komisionit të Posaçëm Parlamentar të Reformës në Sistemin e Drejtësisë si dhe Komisionit Parlamentar të Ligjeve, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut, nga ana tjetër.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI



unicef 
for every child

- 3.2 Në bazë të këtij Memorandumi, UNICEF dhe komisionet parlamentare, nënkomisionet parlamentare, grupi i deputetëve “Miqtë e fëmijëve” ose grupimet e tjera që kanë në fokus të tyre çështjet e fëmijëve mund të hartojnë Plane Veprimi me detyra, përgjegjësi dhe afate të qarta dhe bien dakord lidhur me aktivitetet, për zbatimin e të cilave UNICEF do të ofrojë mbështetje teknike.
- 3.3 UNICEF dhe komisionet parlamentare, nënkomisionet parlamentare, grupi i deputetëve “Miqtë e fëmijëve” ose grupimet të tjera që kanë në fokus të tyre çështjet e fëmijëve mund t’i rishikojnë dhe rifreskojnë këto Plane Veprimi, në varësi të përparimit të arritur dhe sfidave të reja që mund të dalin përgjatë bashkëpunimit mes Palëve.
- 3.4 Fusha e veprimtarisë së këtij Memorandumi, është zbatimi i Rezolutës së sipërpërmendur, Planeve përkatëse të Veprimit dhe/ose letërkëmbimit mes UNICEF-it dhe grupeve a komisioneve parlamentare.

NENI 4

Detyrimet e Palëve

- 4.1 Në përputhje me Nenin 1, **Kuvendi**, përmes komisioneve, nënkomisioneve dhe/ose grupeve parlamentare, merr përsipër:
- (i) Të ndërmarrë dhe mbështetë nisma ligjore për të siguruar përputhshmërinë e legjislacionit shqiptar me standardet ndërkombëtare dhe ato të Këshillit të Evropës lidhur me të drejtat e fëmijës, si dhe për të përafruar gradualisht

